



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-232

PËR SHËRBIMIN GJEOLGJIK TË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËRBIMIN GJEOLGJIK TË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, detyrat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** – Ministria përkatëse për sektorin mineral;

1.2. **Ministër** - Ministri përkatës për sektorin mineral;

1.3. **SHGJK** – Shërbimi Gjeologjik i Kosovës;

1.4. **Drejtori** - Drejtori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj, të cilat nuk janë të përfshira në këto përkufizime, kanë kuptimin e shprehjeve të përdorura në Ligjin në për Minierat dhe Mineralet.

Neni 3 Themelimi, Statusi dhe Selia

1. Më këtë ligj themelohet Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, në kuadër të Ministrisë.
2. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.
3. Selia e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është në Prishtinë.

Neni 4 Stema

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës e ka stemën, e cila propozohet nga drejtori dhe miratohet nga ministri.

Neni 5 Udhëheqja

SHGJK udhëhiqet nga drejtori, i cili për menaxhimin dhe administrimin e SHGJK-së, i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit.

Neni 6 Drejtori

Drejtori emërohet dhe shkarkohet në pajtim me legjislacionin në fuqi për Pozitat të Larta Drejtuese në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 7 Funkcionet e Drejtorit

1. Drejtori ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:
 - 1.1. organizon dhe udhëheqë veprimtarinë e përgjithshme të SHGJK-së;

- 1.2. programon objektivat e SHGJK-së dhe implementon politikat dhe Programin e Qeverisë si dhe koordinon të gjitha projektet për hulumtime gjeologjike;
- 1.3. mbikëqyrë veprimtarinë e departamenteve, si dhe analizon realizimin e detyrave të planeve të punës;
- 1.4. vendosë për shpenzimet e buxhetit, për probleme që lidhen me administrimin dhe përdorimin e mjeteve financiare të mjediseve të punës, teknikës dhe logjistikës;
- 1.5. siguron udhëzime të sakta e të paanshme dhe këshilla profesionale për institucionet publike.
- 1.6. përgatit dhe i dorëzon ministrit raport të hollësishëm vjetor lidhur me veprimtarinë e SHGJK-së.
- 1.7. përfaqëson SHGJK-në, në marrëdhënie me palët e treta.

Neni 8 Personeli

Personeli i punësuar në SHGJK-së, e ka statusin e nëpunësit civil.

Neni 9 Organizimi dhe struktura

Me propozim të Drejtorit, Ministri nxjerr akt nënligjor për organizimin dhe strukturën e brendshme të SHGJK-së.

Neni 10 Detyrat dhe përgjegjësitë

1. SHGJK ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Hulumtimet gjeologjike me interes për Republikën e Kosovës;
- 1.2. bënë studimin gjeologjik dhe gjeokimik të territorit të Kosovës dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja për territorin e Kosovës;

- 1.3. bënë hulumtime dhe vlerësime të resurseve minerale, ujërave nëntokësor, ujërave mineral dhe gjeotermal.
- 1.4. bënë hulumtime gjeologo-inxhinierike;
- 1.5. siguron Kadastrës Minerare dhe GIS-it të KPMM-së të dhëna të azhurnuara nga baza shtetërore e të dhënave gjeologjike, arkiva gjeologjike dhe të dhëna tjera gjeologjike;
- 1.6. bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse në hartimin e Strategjisë Minerare;
- 1.7. ofron analiza objektive dhe të paanshme për autoritetet publike dhe organizatat e sektorit privat, brenda fushës së ekspertizës së SHGJK-së;
- 1.8. hulumton dhe promovon veprimtari që kanë për qëllim zvogëlimin e ndotjes së gjeomjedisit;
- 1.9. krijon, mirëmban, pasuron dhe zgjeron bazën shtetërore e të dhënave gjeologjike, si dhe një arkiv gjeologjik;
- 1.10. kryen shërbime të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime për qëllime dhe fushën e përcaktuar më këtë ligj
- 1.11. bënë studime dhe monitorim të vazhdueshëm të aktivitetit sizmik;
- 1.12. harton programe dhe projekte hulumtuese për institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione për qëllime dhe fushën e përcaktuar më këtë ligj;
- 1.13. i paraqet ministrit raport vjetor për veprimtarinë hulumtuese të zhvilluar, raport ky, i cili pas aprovimit bëhet publik;
- 1.14. menaxhon me Laboratorin dhe kryen analiza profesionale laboratorike për hulumtime gjeologjike;
- 1.15. kryen studime të gjeorreziqueve;
- 1.16. propozon akte nënligjore për zhvillimin e sektorit të Gjeologjisë;

Neni 11

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve – “Trepça”

1. Në kuadër të SHGJK-së ushtron veprimtarinë Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve – “Trepça”.

2. Veprimtaria e muzeut përfshinë: mbledhjen, ekspozimin, ruajtjen, analizimin dhe përpunimin në mënyrë profesionale dhe shkencore, sistematizimin në grupe, mbrojtjen e përhershme të mineraleve/kristaleve dhe dokumentacionit.

Neni 12 Buxheti

1. Drejtori përgatit buxhetin e SHGJK-së, të cilin ia përcjell ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtori është përgjegjës për menaxhimin eficient të buxhetit të SHGJK-së, në pajtim me ligjin.
3. Të hyrat buxhetore që krijohen nga veprimtaria e SHGJK-së, menaxhohen në përputhje me Ligjin në fuqi për menaxhimin e financave publike.

Neni 13 Bashkëpunimi me institucione të tjera

1. SHGJK-ja bashkëpunon me institucione të tjera, në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe ofron informacione gjeoshkencore për institucionet publike në Republikën e Kosovës.
2. SHGJK-ja ofron bashkëpunim profesional, edukativ me Fakultetin e Gjeoshkencave për përdorimin e Laboratorit për qëllime studimi dhe hulumtimi, duke krijuar edhe kosto financiare që gjeneron ky shërbim, kosto e cila mbulohet nga Fakulteti i Gjeoshkencave.

Neni 14 Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren nga Ministria, brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 15 Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës – AGJK-së, i kalojnë SHGJK-së.

Neni 16
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Neni 77 dhe 78, i Ligjit Nr. 03/L-163, për Minierat dhe Minerale; neni 46 dhe 47, i Ligjit Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale; Rregullorja Nr. 03/2012 për Organizimin dhe Funkcionimin e Institutit Gjeologjik të Kosovës, si dhe çdo akt tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-232
14 mars 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI